



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE" VLORE

VENDIM

Nr 1, Dt. 29.09.2009

Per miratim te kerkeses per marrje leje, per perdorim uji, prej burimeve ujore te lumit Langarice (Dege e lumit Vjose), per prodhim te energjise elektrike nepermjet HEC –it Gostivishte, HEC-it "Langarica 3" dhe HEC-it "Ura e Dashit", subjektit "Energia Pulita" sh.p.k Durres

Ne plotesim te kerkeses te bere prej subjektit "Energia Pulita" sh.p.k dhe ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr.9663, dt. 18.12.2006 per "Koncesionet", vendimit te K.M nr.27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve" vendimit nr.3, dt. 19.07.2002 te K.K.U-se, "Per miratimin e rregullores te sekretariatit Teknik" te K.K.U-it, te K.B.U -se dhe A.U.B, udhezimit te M.M.P.A.D dhe M.E.T.E, Vendimit nr.1191, dt. 20.08.2008 te K.M "Per percaktimin e autoritetin kontraktues per dhenien me koncesion te HEC Gostivishte, HEC "Langarica 3" dhe HEC "Ura e Dashit", dhe miratimin e bonusit per proceduren perzgjedhese konkurese qe i jepet shoqeirse", si dhe kontrates koncesionare te formes "BOT" per ndertimin e hidrocentraleve, HEC Gostivishte, HEC "Langarica 3" dhe HEC "Ura e Dashit", Nr. 2866 date 07/09/2009 lidhur ndermjete M.E.T.E dhe shoqeris "Energia Pulita" sh.p.k Durres. Duke mare ne konsiderat dokumentacionin e mesiperm, kerkesen e subjektit, si dhe vendimin nr 1 date 17/01/2008 te KBU "Vjose", per miratim te kerkeses per dhenie me koncesion te burimit ujqor te lumit te Gostivishtit per prodhim te Energjise Elektrike, nepermjet HEC "Langarica 3", si dhe relacionin e paraqitur nga A.U.B "Vjose", K.B.U "Vjose",

VENDOSI:

1- Miratimin e kerkeses te bere nga shoqeria " Energia Pulita" sh.p.k Durres, per leje, "Per perdorim te burimit ujqit" te lumit Langarice, (dege e lumit Vjose) per prodhim te energjise elektrike, Nepermjet HEC –it Gostivishte, HEC-it "Langarica 3" dhe HEC-it "Ura e Dashit".

2- Veprat e marrjes, do te jene ne vendet e percaktuar sipas kordinatave (kuotave), ne kontraten koncesionare Nr. 2866, date 07/09/2009 lidhur mes M.E.T.E dhe shoqeris "Energia Pulita" sh.p.k Durres :

Vazhdim i Vendimit Nr 1, Dt. 29.09.2009

a-HEC "Gostivisht":

- Vepra e Marrjes ne Lumin e Anit ne kuoten 750m.
- Vepra e Marrjes ne perroin e Varvadollit ne kuoten 650 m.
- Vepra e Marrjes ne Lumin e Gostivishtit ne kuoten 679m.
- Vepra e Marrjes ne vendbashkimin e perrenjve, Sopot, Nishan dhe Mehalle, ne kuoten 678,2m.

b- HEC "Langarica 3"

- Vepra e Marrjes ne Lumin Gostivishte ne kuoten 568m.

c- HEC, "Ura e Dashit"

- Vepra e Marrjes ne Lumin Langarice ne kuoten 431m.

3- Sasia e ujit qe jepet ne perdorim per prodhim te energjise elektrike do te jete:

- a) HEC "Gostivisht" – 1.5 m³/sek
- b) HEC "Langarica 3" – 5 m³/sek
- c) HEC "Ura e Dashit" – 8 m³/sek

4 - Periudha e perdorimit te ujit do te jete gjate gjithë vitit, perjashto periudhen nga 1 Qershor deri ne 30 Shtator te cdo viti, ku prurjeve te mesiperme te ujit, do tu zbriten sasia e ujit qe do te perdoret per ujitjen e kulturave bujqesore - 0.2 m³/sek

5 - Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.

6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere .

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"
Vezir METAJ



KRYETARI I K.B.U "VJOSE"
Hasan HALILI

